

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE
"BIKADE " SH.P.Sh! Import -Eksport

Sot me date 9.2.1995 une i quajturi Idriz Sali Kasa me datelindje 42
1942 lindur dhe banues ne Elbasan, lagjia " R_e " themeloj shoqe-
rine me pergjegjesi te kufizuar si ortak i vetem.

NENI 1

Shoqeria emerohet "BIKADE" sh.p.k. import-eksport.

NENI 2

Selia e shoqerise eshte ne Elbasan lagjia Re.

NENI 3

Shoqeria ka nje aktivitet te saj mbi 10 vjet dhe mund te shper-
behet, ne cdo kohe.

NENI 4

Shoqeria ka per aktivitet te saj:

- Tregetim te artikujve te ndryshem industriale dhe ushqimore produkte
bujqesore dhe blektorale, fruta-perime me shumice dhe me pakice. Eksport-
import. Tregetim i produkteve dhe nenprodukteve te mishit eksport-impor-
- Tregetim materiale ndertimi.
- Prodhim dhe tregetim objekte me materiale duralumini dhe hekuri (dyer, dr-
tare, kjoska etj) me shumice dhe me pakice. Import -Eksport.

NENI 5

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke.

ORTAKU I VETEM

IDRIZ KASA

Elbasan me 9.2.1995



NOTERIA ELBASAN

308

VERTETIM

Sot me date 9.2.1995 ne zyren e noterise ne Elbasan para meje no-
tes Majlinda "ato u paraqit personalisht Idriz Kasa i biri i Saliut
ues ne Elbasan madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike shtet
shqiptare i cili mu be i njohur ne baze te leternjoftimit qe me par
dhe deklaroi se sa me sipër eshte shkrojtur konform vullnetit te tij
line

NOTER E MAJLINDA LATO



STATUTI I SHOQERISE
"BIKADE" SH.P.K. IMPORT-EKSPORT
(ORTAK I VETEM)

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare me emertim "BIKADE" me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar nga ortaku i vetem z. Idriz Kasa i biri i Saliut lindur me 1942 banues ne Elbasan, lagjia e Re.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqerise eshte ne Elbasan, lagjia e Re. Shoqeria mund te hape edhe vendqendrim te tjera te dyta, operative, filjale, perfaqesi dhe agjenci ne te gjitha territorin e vendit.

KOHE ZGJATJA

NENI 3

Koha e zgjatjes se veprimtarise ekonomike te shoqerise esht mbi dhjete vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Veprimtaria tregtare e shoqerise eshte sa vijon:

- Tregetim i mishit, i produkteve dhe nenprodukteve te tij import dhe eksport i tyre.
 - Tregetim i artikujve te ndryshem industriale dhe ushqimore, fruta per me shumice dhe me pakice, produkte bujqesore dhe blektorale. Import-Ekport.
 - Tregetim materiale ndertimi.
 - Prodhim dhe tregetim objekte me materiale duralumini dhe hekuri (dyer dritare, kjoska etj) me shumice dhe me pakice. Import-Eksport.
- Si dhe cdo aktivitet tjeter qe vecas ose se bashku me ato te permen rise. me siper do te ndikojne ne zhvillimin e rritjen e veprimtarise se sh

NENI 5

Shoqeria mund te ndryshoje emerimin, seline si dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre pronari i saj.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke, i formuar ne masen e nga ortaku i vetem.

NENI 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit qe do te marre ortakut i vetem.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 8

SHoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Shoqeria fiton zotetirine per te vepruar me regjistrimin e saj si person juridik ne Gjykatën e Tiranës dhe ndërsa ushtron aktivitetin tregëtar me regjistrimin ne zyren e Tatim Taksave.

NENI 9

Shoqeria ka vullen e saj me pembajtjen SHOQERIA TREGËTARE "BIKADE" sh,p,k, IMPORT-EKSPORT.

NENI 10

Shoqeria tregëtare vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet.

Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore e jashte kontraktore brenda kapitalit te saj. Ortaku i saj i vetem mbart rrezikun e vepruarise se shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara ne shoqeri.

NENI 11

Shoqeria eshte prone e themeluesit te saj. Ajo merr persiper vendime ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe sipas ketij statuti te cilat jane te detyrueshme per te gjithë punonjesit ne kete shoqesi.

NENI 12

Ortakut i vetem sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise se shoqerise emeron Administrator si dhe puneson punonjes te veprimtarive te ndryshme ekonomike te permendura ne nenin 4 te ketij statuti.

NENI 13

Ortakut i vetem i shoqerise dhe Administratori i ngarkuar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise pa asnje lloj kufizimi. Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe konsiderojne te nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise. Ata kane te drejte midis te tjerave te blejne e te kembujne pasuri, te lidhen me shoqeri te tjera te vendit ose te huaja, te kryejne e cdo lloj veprimi prane te gjithave zyrave private apo shteterore qe kane te bejne me garancite, ipotekat. Te kryejne prane institucioneve bankare e financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesat dhe arketimet. Ne keto raste Administratori i ngarkuar ka per detyre te njoftoje dhe te japi llogari ortakut te vetem.

NENI 14

NENI 14

Perfaqesimi i shoqerise i perket ortakut te vetem dhe "dministratorit te ngarkuar. Ata kane te drejten e perfaqesimit te shoqerise ne organet gjyqesore dhe administrative, te caktoje dhe te pushoje avokat per cdo probelem.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 15

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise mbyllen me 31dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore Administratori nxjerr bilancin kontabel te shoqerise me llogarine FITIM-HUMBJE, mbeshtetur ne ligje dhe rregulla te mbajtjes se kontabilitetit nga subjektet private percaktuar nga organet kopetente te sistemit fiskal. Bilanci kontabel miratohet nga ortaku i vetem i cili vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme per zhvillimin e garancine e veprimtarise se shoqerise. Fondin e akumulimit, fondin rezerve etj.

NENI 16

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve ligjore te permendura me shprehje dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale nga fitimet i mbesin per perdorim ortakut te vetem.

SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 17

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfare do shkakq humbja e kapitalit, pamund sia e veprimtarise. Ne keto raste ortaku i vetem vendos per menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdator. Keta bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje me pare detyrimet qe ajo ju duhet personave te trete fizike dhe juridike.

DISPozitat E PERGJITHSHME

NENI 18

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve nga ortaku i vetem si dhe ligjeve perkatese shqiptare.

NENI 19

Ky statut perpilohet ne kater kopje per tju shperndare organet kopetente, ndersa nje kopje mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te themelimit te shoqerise.

ORTAKU I VETEM

IDRIZ KASA

